

Zenith Travel Sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

Raporti i Audituesit të Pavarur.....	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	5
Pasqyra e Performancës	6
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	8
1. Informacion i përgjithshëm.....	9
2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare	9
3. Politikat kontabël.....	9
4. Para në arkë dhe bankë	12
5. Llogari të arkëtueshme	12
6. Llogari të arkëtueshme të tjera.....	12
7. Aktivet afatgjata materiale	13
8. Hua.....	13
9. Të pagueshme trgtare	13
10. Detyrime tatimore dhe të tjera	14
11. Hua afatgjatë.....	14
12. Të tjera të pagueshme	14
13. Kapitali i paguar	14
14. Fitimi i pashpërndarë.....	14
15. Të ardhurat.....	14
16. Kosto e shërbimeve dhe materialeve	14
17. Shpenzime të personelit	15
18. Shpenzime operative	15
19. Të ardhura financiare	15
20. Tatim fitimi	15
21. Angazhime dhe kushtëzime	16
22. Ngjarje pas periudhës raportuese	16



J2N1 sh.p.k

NUIS: M11809040U

Rruga Asim Vokshi,

Nd. 14, H. 6, A. 27,

1016, Tiranë, Shqipëri

M: +355 69 707 0276

E: dkalemasi@joncon.al

Raport i Audituesit të Pavarur

Për aksionarin e Zenith Travel sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Zenith Travel Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri ("SKK").

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijmësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit.
- Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhshmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjerave, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.


Ditjon Kalemasi
Auditues Ligjor



24 Qershor 2025
Tiranë, Shqipëri

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET	Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivët Afatshkurtra			
Para në arkë dhe bankë	4	1,000,421	2,617,938
Llogari të arkëtueshme, klientë	5	25,265,767	33,607,876
Llogari të arkëtueshme të tjera	6	12,119,013	10,860,667
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		38,385,201	47,086,481
Aktivët Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	69,638,233	72,796,969
Totali i Aktiveve Afatgjata		69,638,233	72,796,969
TOTALI I AKTIVEVE		108,023,434	119,883,450
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet Afatshkurtra			
Hua afatshkurtër	8	-	676,864
Të pagueshme tregtare	9	8,956,390	6,359,954
Detyrime tatimore dhe të tjera	10	7,115,138	6,924,201
Të ardhura të shtyra		3,800,000	40,300,000
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		19,871,528	54,261,019
Detyrimet Afatgjata			
Hua afatgjatë	11	21,590,178	28,482,189
Të tjera të pagueshme	12	36,361,727	13,259,575
Totali i Detyrimeve Afatgjata		57,951,905	41,741,764
Kapitali			
Kapitali i paguar	13	800,000	800,000
Rezerva		2,296	2,296
Fitimi i pashpërndarë	14	23,078,371	16,843,153
Fitimi i vitit	20	6,319,334	6,235,218
TOTALI I KAPITALIT		30,200,001	23,880,667
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		108,023,434	119,883,450

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë aprovuar nga drejtimi më 20 mars 2025 dhe firmosur nga:

Administrator
Bledar SULA

Hartuese e Pasqyrave Financiare
Lionika ALLMUÇA

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 9 deri 15.

Pasqyra e Performancës

Të ardhurat	Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	144,326,801	116,232,302
Të ardhura të tjera shfrytëzimi	15	750,000	4,248,000
Totali i të ardhurave		145,076,801	120,480,302
Lënda e parë dhe të tjera shpenzime			
Kosto e shërbimeve	16	(47,779,292)	(42,356,257)
Të tjera shpenzime			
Totali		(47,779,292)	(42,356,257)
Shpenzime personeli	17	(19,709,486)	(17,073,243)
Amortizimi	7	(9,327,489)	(8,057,694)
Shpenzime operative	18	(58,837,266)	(42,411,528)
Shpenzime financiare, neto	19	(1,951,374)	(3,243,976)
Totali i shpenzimeve		(89,825,615)	(70,786,441)
Fitimi para tatimit		7,471,894	7,337,604
Shpenzimi për tatim fitimin	20	(1,152,560)	(1,102,386)
FITIMI I VITIT	20	6,319,334	6,235,218

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

	Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fluksi mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit:			
Fitimi i periudhës	19	6,319,334	6,235,218
<i>Rregullime për shpenzimet jo-monetare:</i>			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	9,327,489	8,057,694
Ndryshim në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit			
Rënie/(Rritje) në te drejtat e arketueshme	5,6	7,083,763	(2,774,675)
Rënie/(Rritje) në inventar		-	-
Rënie/(Rritje) në shpenzime të shtyra			
Rritje/(Rënie) në detyrime të pagueshme	10-13	(18,179,350)	26,024,685
Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit		4,551,236	37,542,922
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	9	(6,168,753)	(51,099,637)
Mjete monetare neto nga aktivitetet e investimit		(6,168,753)	(51,099,637)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet e financimit			
Hua të arkëtuara			
Arkëtime në avancë			
Dividendë të paguar		-	-
Mjete monetare neto nga aktivitetet e financimit		-	-
Rritje/(rënie) neto në mjetet monetare		(1,617,517)	(13,556,715)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim	4	2,617,938	16,174,653
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund	4	1,000,421	2,617,938

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva	Fitme të pashpërndara	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31.12.2022	800,000	2,296	9,271,403	7,571,750	17,645,449
Transferuar në rezerva	-	-	7,571,750	(7,571,750)	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	6,235,218	6,235,218
Pozicioni financiar më 31.12.2023	800,000	2,296	16,843,153	6,235,218	23,880,667
Transferuar në rezerva	-	-	6,235,218	(6,235,218)	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	6,319,334	6,319,334
Pozicioni financiar më 31.12.2024	800,000	2,296	23,078,371	6,319,334	30,200,001

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. Informacion i përgjithshëm

Zenith Travel Sh.p.k ("Shoqëria") u krijua si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 12 Tetor 2011. Kapitali i shoqërisë përbëhet prej 800 kuta me vlerë 1,000 lekë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është fushën e transportit të udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit për vete dhe të tretë. Agjenci turistike dhe operator turistik.

Adresa e shoqërisë është Rruga e Durrësit, Nd. 220, H. 3, K. 1, Ap. 17, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 Dhjetor 2024, shoqëria kishte 29 punonjës.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe me Ligjin Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të jetë në gjëndje të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet gjatë rrjedhës normale të aktivitetit për periudhën pasardhëse 12 mujore.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë. Në datën 31 dhjetor zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit të datës së mbylljes së këtyre pasqyrave si në tabelë:

Monedha	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
1 EUR	98.15	103.88
1 USD	94.26	93.94

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjëndje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

3.1 Aktivët afatgjatë

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit madhor) më vete të aktivit. Fitimet dhe humbjet në dispozicion të një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të elementit dhe njihen për vlerën neto në zërin "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të aktivit nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupëzuara do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare për përmirësimet e ambjenteve me qira dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera, gjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga dita e parë e muajit pas muajit të blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|----------------------------|
| • Ndërtesa | vlera e mbetur me 5% |
| • Automjete | vlera e mbetur me 20% |
| • Pajisje Zyre & Informatike | vlera e mbetur me 20 – 25% |
| • Aktivët jomateriale | vlera e mbetur me 15% |

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.2 Zhvlerësimi

Aktivet financiare

Aktivi financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive të zhvlerësimit si pasojë e një apo disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, të cilat kanë ndikim në flukset monetare që rrjedhin nga aktivi financiar dhe që mund të maten në mënyrë të besueshme. Humbja nga zhvlerësimi i një

aktivi financiar i matur me koston e amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së tij të akumuluar dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare, të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivitetet e rëndësishme financiare testohen individualisht për zhvlerësim në mënyrë periodikë. Pjesa e mbetur e aktiveve shqyrtohen në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ky anulim lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur kjo humbje. Për aktivitetet financiare të llogaritura me koston e amortizuar, anulimi njihet në pasyrën e të ardhurave.

3.3 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat llogariten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për shitjen e mallrave në rrjedhën normale të biznesit, duke marrë parasysh skontimet dhe uljet e ofruara. Të ardhurat njihen kur ofrohen shërbimet.

3.4 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kurset e këmbimit.

3.5 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual i cili njihet në "Pasyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve". Taktimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat e tatimore të aplikuara në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

3.6 Shpërblimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Kompania nuk bën provizione dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi kontributet e paguara në Institutin Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore. Kostot respektive në emër të kompanisë njihen në Pasyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, në momentin që ndodhin.

3.7 Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të mëvonshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethanat aktuale.

Vlerësimet dhe hipotezat që mbartin riskun e shkakut të një rregullimi material në vlerat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm fiskal, janë të listuara më poshtë.

Taksat mbi të ardhurat

Kompania është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri. Për të përcaktuar nivelin e taksave të shtyra mbi të ardhurat nevojitet një gjykim i kujdesshëm. Ka një numër transaksionesh dhe llogaritjesh për të cilat një përcaktim përfundimtar i taksave është i pasigurt. Kompania njihet detyrimet për çështje të pritshme që lidhen me auditimin fiskal bazuar në vlerësimet nëse do të ketë taksa shtesë për t'u paguar.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

4. Para në arkë dhe bankë

Paraja cash dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Para në arkë	35,673	-
Para në bankë	964,748	2,617,938
Total Mjete Monetare	1,000,421	2,617,938

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në Shqipëri si dhe gjëndja e arkës në datën e raportimit.

5. Llogari të arkëtueshme

Llogari të arkëtueshme nga klientët në datën 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga klientët	25,265,767	33,607,876
Llogari të arkëtueshme neto	25,265,767	33,607,876

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshme nga klientët për shitjen e mallrave dhe produkteve të tjera nga aktiviteti kryesor i Shoqërisë.

6. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogari të arkëtueshme të tjera në datën 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Tatimi mbi vlerën e shtuar	12,086,912	10,650,177
Parapagime në doganë	23,354	11,217
Të tjera	-	34,121
Tatimi mbi fitimin	8,747	165,152
Totali	12,119,013	10,860,667

Llogaritë të arkëtueshme të tjera përfshijnë të arkëtueshme parapagimet e bëra për furnitorë për shërbime dhe paketa të së ardhmes.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

7. Aktivet afatgjata materiale

	Toka & Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>				
Më 1 janar 2023	-	29,322,322	432,705	29,755,027
Shtesa	38,717,000	15,466,559	322,042	54,505,601
Pakësime	-	(3,405,965)	-	(3,405,965)
Më 31 dhjetor 2023	38,717,000	41,382,916	754,747	80,854,663
Shtesa	-	8,818,143	-	8,818,143
Pakësime	-	(2,649,390)	-	(2,649,390)
Më 31 dhjetor 2024	38,717,000	47,551,669	754,747	87,023,416
<i>Amortizim i akumuluar</i>				
Më 1 janar 2023	-	-	-	-
Shpenzime për vitin	(967,925)	(6,995,833)	(93,936)	(8,057,694)
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2023	(967,925)	(6,995,833)	(93,936)	(8,057,694)
Shpenzime për vitin	(1,610,904)	(7,584,422)	(132,163)	(9,327,489)
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	(2,578,829)	(14,580,255)	(226,099)	(17,385,183)
<i>Vlera e mbartur</i>				
Më 31 dhjetor 2022	-	29,322,322	432,705	29,755,027
Më 31 dhjetor 2023	37,749,075	34,387,083	660,811	72,796,969
Më 31 dhjetor 2024	36,138,171	32,971,414	528,648	69,638,233

8. Hua

Hua më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Hua	-	676,864
Totali	-	676,864

Hua më 31 dhjetor 2024 përfaqëson shumat që shoqëria i detyrohet të tretëve. Këto shuma janë arkëtuar në llogari të shoqërisë si pasaoj e gabimit nga paguesit dhe janë kthyer tek ta pas datë së këtyre pasqyrave financiare.

9. Të pagueshme tregtare

Të pagueshme tregtare më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Furnitorë për shërbime	8,956,390	6,359,954
Totali	8,956,390	6,359,954

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

10. Detyrime tatimore dhe të tjera

Të pagueshme për detyrime tatimore më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Kontributet shoqërore e shëndetësore	392,310	350,686
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi (TAP)	14,015	11,538
Tatimi i mbajtur në burim	6,000	6,000
Paga të pagueshme	6,702,813	6,555,977
Totali	7,115,138	6,924,201

11. Hua afatgjatë

Hua afatgjatë më 31 dhjetor 2024 përfaqëson shumën e mbetur nga financimi që shoqëria ka marrë në një nga bankat e nivelit të dytë për blerjen e aktiveve afatgjata materiale. Huaja është me afat 5 vjeçar dhe data e maturimit është 08.06.2028.

12. Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2024 përfaqëson shumat e mbetura nga huatë e marra nga palët e lidhura për financimin e aktivitetit të shoqërisë. Këto shuma janë marrë pa interes.

13. Kapitali i paguar

Më 31 dhjetor 2024 ortak i vetëm i Shoqërisë është Z. Bledar Sula. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 800,000 LEK (2023: 800,000 LEK) i përbërë nga 800 kuota me vlerë nominale 1,000 Lekë secila.

14. Fitimi i pashpërndarë

Fitimet e pashpërndara me qëllim zgjerimin e aktivitetit nga Shoqëria më 31 dhjetor 2024 kanë një vlerë prej 23,078,371 LEK (2023: 16,843,153 LEK).

15. Të ardhurat

Të ardhurat më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga shërbimet	144,326,801	116,232,302
Të ardhura nga shitja e aseteve	750,000	4,248,000
Totali	145,076,801	120,480,302

16. Kosto e shërbimeve dhe materialeve

Në këtë zë paraqitet kosto e shërbimeve, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Shpenzimet për lëndën e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2023
Kosto e shërbimeve	47,779,292	42,356,257
Totali	47,779,292	42,356,257

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

17. Shpenzime të personelit

Shpenzimet të personelit më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Pagat e personelit	16,888,962	14,630,184
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	2,820,524	2,443,059
Totali i shpenzimeve të personelit	19,709,486	17,073,243

18. Shpenzime operative

Shpenzimet operative më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2023
Shpenzime operative	58,837,266	42,411,528
Totali	58,837,266	42,411,528

19. Të ardhura financiare

Të ardhura financiare më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shpenzime interesi	1,651,051	1,061,409
Humbje nga kurset e këmbimit	300,323	2,182,567
Shpenzime financiare neto	1,951,374	3,243,976

20. Tatim fitimi

Shpenzimet lidhur me tatimin mbi fitimin më datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	7,471,894	7,337,604
Shpenzime të pazbritshme	211,839	11,636
Fitimi /(humbja) tatimore për vitin	7,683,733	7,349,240
Tatimi mbi fitimin 15%	(1,152,560)	(1,102,386)
Fitimi NETO i vitit	6,319,334	6,235,218

Norma efektive e tatimit mbi fitimin paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	Norma efektive tatimore	31 Dhjetor 2023	Norma efektive tatimore
Fitimi për vitin	7,471,894		7,337,604	
Tatimi mbi fitimin 15%	1,120,784	15.00%	1,100,641	15.00%
Shpenzime të pazbritshme	31,776	0.43%	1,745	0.02%
Totali i tatimit mbi fitimin	1,152,560	15.43%	1,102,386	15.02%

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

21. Angazhime dhe kushtëzime

Angazhime

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nënkontraktuara në datën e pasqyres së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2024 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore të Shoqërisë mund të mos konsiderohen të finalizuara.

Çështje Gjyqësore

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria ndeshet me pretendime ligjore dhe gjyqësore; menaxhimi i Shoqërisë është i mendimit se asnjë humbje materiale nuk do të shkaktohet në lidhje me kërkesat ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2024.

22. Ngjarje pas periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të ndodhura pas datës së mbylljes së pasqyrave financiare që kërkon rregullime të pasqyrave financiare ose dhënie të shpjegimeve plotësuese për to.